

**STATUTI
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"FVF" FUTURE VALUE FORMULA SHPK**

Sot më datë 23.02.2021 Partnerët Themelues:

1. Znj. Rozana Plaku, lindur në Roskovec, datë 11/02/1983 dhe banues në Fier, shtetas shqiptar, i identifikuar me leternjoftimin nr.035720242, lëshuar në datë 28.01.2020 , person madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

I cili në vijim do të konsiderohet ortak i vetëm, bazuar në vullnetin e tij të lirë dhe në përputhje me Ligjin Nr.9109, datë 17.7.2003, i ndryshuar, ka vendosur të nënshkruajë Statutin e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe nga ky statut.


KAPITULLI I

Neni 1- themelimi, Forma dhe Ortakët

- 1.1 Ortaku i vetëm i Shoqërisë ka vendosur të krijojë një shoqëri me përgjegjësi tëkufizuar emërtimi i së cilës do të jetë "FVF" Future Value Formula shpk"
- 1.2 Shoqëria "FVF" Future Value Formula " shpk është krijuar si një Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
- 1.3 Shoqëria do të funksionojë sipas legjislacionit shqiptar.
- 1.4 Statuti është në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në të, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 2 - Emërtimi

- 2.1 Emërtimi shoqërisë është "FVF" Future Value Formula sh.p.k



Neni 3- Objekti i Shoqërisë

3.1 Objekti i shoqërisë përfshin ofrimin e konsulences ne fushen financiare, tregtise, analiza biznesi dhe marketing. Pjesë e veprimtarisë së saj do të jenë edhe tregëtimi dhe shitja e aparaturave elektronike, printime, design, prodhimi I tabelave brail, materiale marketingu, ndërtim dhe ngritje website, si dhe ndërtim dhe zhvillim teknologjie VR për aplikacione të ndryshme, ndertim platform elektronike per telefona celulare IOS dhe Android, krijimi I QR Code te objekteve te ndryshme. Gjithashtu ofrojme sherbime perkthimi nga gjuha italiane dhe angleze, redaktime/ korrektme materialesh studimore.

Neni 4 - Selia

- 4.1. Selia e Shoqërisë është: Lagjen 29 Nentori, Rruga Todi Shkurti, Shtepia nr.1 Prane Gjykates, Fier
- 4.2. Transferimi i selisë së shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendimin e Asamblesë së ortakëve me shumicë të kualifikuar.
- 4.3. Asambleja e ortakëve me shumicë të kualifikuar mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë si dhe jashtë saj.


Neni 5-Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 5.1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë **pa afat**.
- 5.2. Shoqëria mund të priset përpara këtij afati ose mund të zgjasë kohëzgjatjen e saj me vendim të Asamblesë së Ortakëve me shumicë të kualifikuar.

Neni 6- Përgjegjësia

- 6.1. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra për qëllime që nuk përputhen me ato të përcaktuara nga Statuti dhe Akti i Themelimit.
- 6.2. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra nga ortakët në emër të tyre personal ndaj personave fizikë ose juridikë, privatë ose shtetëror.

KAPITULLI II

A handwritten signature in black ink, appearing to be a stylized name, possibly 'L. L. L.', written over a horizontal line.

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA E KUOTAVE TË KAPITALIT

Neni 7- Kontributet

7.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:

Znj. Rozana Plaku, lindur në Roskovec, datë 11/02/1983 dhe banues në Fier, shtetas shqiptar, i identifikuar me leternjoftimin nr.035720242, lëshuar në datë 28.01.2020, person madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar

7.2 Sipas kontributeve të mësipërme:

- Ortakut të vetëm Znj. Rozana Plaku, i përket 1 (një) kuotë, që i korrespondojnë 100% (njëqind për qind) të kuotave të kapitalit të shoqërisë, e gjitha e nenshtruar në vlerën nominale 100 (njëqind) leke.

Neni 8-Rritja e kapitalit themeltar

8.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Shoqërisë, marrë me shumicë të kualifikuar.


8.2 Në rast të rritjes së kapitalit, kuotat e ortakëve të Shoqërisë do të rriten sipas shumave të përcaktuara në vendimin asamblesë.

Neni 9- Zvogëlimi i kapitalit themeltar


9.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së Shoqërisë me shumicë të kualifikuar. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.

9.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve sipas shumave të përcaktuar në vendimin e asamblesë.

Neni 10-Transferimi i kuotave të kapitalit dhe e drejta e parablerjes.



- 10.1 Kuotat e kapitalit nuk janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve ose tek të tretët. Transferimi i kuotave, në çdo lloj forme, do të autorizohet me vendim të Asamblesë së Shoqërisë, me shumicë të kualifikuar.
- 10.2 Në rast transferimi të kuotave të kapitalit, në çdo lloj forme, ortaku që do të cedojë kuotat e tij ("Ortaku Cedues"), plotësisht ose pjesërisht, duhet ti ofrojë kuotat e tij fillimisht tek ortakët e tjerë.
- 10.3 Ortaku Cedues, në rast se kjo kërkohet nga shumica e cilësuar e ortakëve të tjerë, duhet të kërkojë që çmimi i kuotave që ka vendosur të cedojë të përcaktohet nga një arbitër ("në vijim Arbitri"). Për këtë qëllim Ortaku Cedues do tu dërgojë një njoftim (në vijim "Njoftimi") ortakëve të tjerë, me letër rekomande me kthim përgjigje, me anë të të cilit komunikon synimin për shitjen e kuotave dhe fton ortakët e tjerë për të zgjedhur tre kandidatë për tu emëruar si arbitër. Kandidatët do të zgjidhen nga sektori bankar dhe/ose institute apo studio konsulence financiare me reputacion të lartë dhe nuk duhet të jenë partnerë të asnjë prej ortakëve ose shoqërive kontrolluese dhe/ose të lidhura. Ortakët duhet ti komunikojnë Ortakut Cedues emrat e kandidatëve të zgjedhur brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e Njoftimit, ndërsa Ortaku Cedues do të komunikojë ortakëve të tjerë dhe për dijeni administratorit, emrin e kandidatit që ka zgjedhur si Arbitër, brenda 10 ditëve pasuese, nëse ortakët e tjerë nuk kanë kryer komunikimin e emrave të kandidatëve për arbitër brenda afatit si më lart, Ortaku Cedues do të zgjedhë Arbitrin nga sektori bankar dhe/ose institute apo studio konsulence financiare me reputacion të lartë, duke njoftuar kështu personin e zgjedhur si Arbitër dhe Administratorin e Shoqërisë.
- 10.4 Arbitri do të përcaktojë çmimin e kuotave sipas nenit 11.2 brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimit sipas nenit 11.3, ose afat tjetër duke konsideruar, midis të tjerave, pasurinë e shoqërisë, parashikimet për të ardhurat dhe vlerën e tregut. Përcaktimi i Arbitrit do të njoftohet Administratorit dhe gjithë ortakëve.
- 10.5 Me caktimin e çmimit për shitjen e kuotave nga Arbitri dhe nëse Ortaku Cedues dëshiron akoma ti shesë ato, ortakët e tjerë kanë të drejtën e parablerjes sipas çmimit të përcaktuar nga Arbitri dhe për këtë duhet të njoftojnë Ortakun Cedues me letër rekomande me kthim përgjigje brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit për çminim e përcaktuar nga Arbitri. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar Ortaku Cedues do të transferojë kuotat në favor të të tretëve me çmin jo më të vogël nga çmimi i përcaktuar nga Arbitri.

A handwritten signature in black ink, consisting of a series of loops and flourishes, positioned at the bottom of the page.

- 10.6 Transferimi i kuotave në favor të të tretëve i nënshtrohet miratimit të ortakëve të tjerë. Ortaku Cedues do të njoftojë paraprakisht ortakët e tjerë me letër rekomande me kthim përgjigje në lidhje me transferimin e kuotave tek të tretët, duke treguar në njoftim emrin e blerësit dhe çmimin e shitjes. Ortakët e tjerë do të komunikojnë miratimin e tyre ose arsyet për mosmiratimin e transferimit të kuotave tek personi i tretë brenda 15 (pesëmbëdhjete) ditëve nga njoftimi i parë. Miratimi nuk do të jepet nëse personi i tretë nuk do të ofrojë garanci për përbushjen e detyrimeve të tij në shoqëri dhe/ose nëse pjesëmarrja e të tretit nuk është në interes të shoqërisë dhe/ose të ortakëve të tjerë.
- 10.7 Në rast të transferimit të kuotave të kapitalit për shkak trashëgimie *mortis causa*, ortakët e tjerë kanë të drejtë të shprehin pëlqimin e tyre për ortakët e rinj. Nëse ortakët e shoqërisë, me shumicë absolute, nuk japin pëlqimin e tyre, do të aplikohen normat si më lart.

KAPITULLI III

ASAMBLEJA, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL


Neni 11- Asambleja e ortakëve dhe kompetencat e saj

11.1 Organi vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.

11.2 Vendimet e Asamblesë së Shoqërisë, për të cilat kërkohet një shumicë e thjeshtë, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm në mbledhje ortakët që përfaqësojnë më shumë se 50% (pesëdhjet për qind) të të gjithë kapitalit themeltar dhe asambleja do të vendosi me votën e ortakëve që përfaqësojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë për qind) të kapitalit themeltar.

11.3 Nëse Asambleja nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmenduar në nenin 11.2 të këtij statuti, Asambleja do të mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, cilido qoftë numri i ortakëve të pranishëm dhe do të vendosi me votën e shumicës së ortakëve të pranishëm, përveç emërimit dhe shkarkimit të administratorit. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 11.2.

11.4 Vendimet e Asamblesë së Shoqërisë, për të cilat kërkohet një shumicë e kualifikuar janë të vlefshme nëse, si në mbledhjen e parë ashtu edhe në mbledhjen e dytë, janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të paktën $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e kapitalit themeltar.


A handwritten signature in black ink, appearing to be a stylized name, possibly 'Rozari', written over a horizontal line.

Neni 12 - E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës

- 12.1 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë vendimin e tij dhe të japë aq vota sa është numri i kapitalit të kuotave që ai zotëron.
- 12.2 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër edhe jo-ortak, i pajisur me prokurëme shkrim, me anën e sëcilës mund të jushtrojë të drejtën e votës.
- 12.3 Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për një pjesë të kuotave të kapitalit që zotëron, në qoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur të kuotave.

Neni 13-Thirrja e Asamblesë së Ortakëve

- 13.1 Asambleja e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit, ekspertit kontabël si dhe inventarit.
- 13.2 Asambleja mund të thirret në çdo moment nga një prej Administratorëve ose nga një ose disa ortakë që përfaqësojnë më shumë se 10 % (dhjetë për qind) të kapitalit themeltar.
- 13.3 Asambleja mund të thirret nëpërmjet telefonit, njoftimit me sms, atij me email apo nëpërmjet njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje që duhet t'u dërgohet ortakëve në adresën që rezulton në Librin e Ortakëve dhe ekspertit kontabël (nëse është emëruar), të paktën 7 (shtatë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi çështjen që do të trajtohet dhe për të cilat do të merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.
- 13.4 Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë, brenda apo jashtë vendit.
- 13.5 Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe ti lejohet atyretë ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të argumentave. Pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet kryetari i Asamblesë
- 13.6 Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht dhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tërë kapitalin themeltar.

A handwritten signature in black ink, consisting of a series of loops and flourishes, positioned at the bottom of the page.

13.7Çdo Asamble drejtohet nga një ortak ose një person tjetër icaktuar nga e njëjta Asamble.Për pasqyrimin e vendimit Asambleja emëron një sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.

13.8Vendimet e Asamblesë mund të nënshkruhen nga Kryetari iAsamblesë dhe nga Sekretari.

Neni 14 -Administrimi

14.1Shoqëria administrohet të paktën nga 1(një) administrator dhe maksimumi 3 (tre) administratorë, të cilët qëndrojnë në detyrë deri në revokimin apo dorëheqjen, për një periudhë maksimale prej 5 (pesë) vjetësh.

14.2Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë i besohet Administratorit, apo Administratorëve bashkërisht, kur rezulton të jenë emëruar më shumë se një. Administratorët do të ushtrojnë të gjitha kompetencat sipas parashikimeve të nenit 95 të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” .

14.3Administratorët mund të emërojnë përfaqësues të posaçëm për akte të veçanta ose për kategori aktesh, për aq sa i është lejuar nga ky Statut apo nga akti i emërimit.

Neni 15 - Eksperti kontabël i autorizuar

15.1Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakëve, kontrolli i bilanceve dhe i Librave kontabël të Shoqërisë mund ti besohet një eksperti kontabël të autorizuar.

15.2Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.


KAPITULLI - IV

VITI FINANCIAR,BILANCI VJETOR,SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 16- Viti financiar dhe bilanci vjetor

16.1Viti financiar fillon me 1 (një) janar dhe mbaron me 31 (tridhjetë e një) dhjetor të secilit vit.

16.2Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërise në Regjistrin Tregtar dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.

A handwritten signature in black ink, appearing to be a stylized name, possibly 'L. J. ...', written over a horizontal line.

- 16.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e administratorit dhe të ekspertit kontabël të autorizuar (nëse është emëruar) miratohen nga Asambleja me shumicën e përcaktuar sipas ligjit 9901, datë 14,04,2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 16.4 Miratimi i dokumenteve që lidhen me vitin financiar të bëhet brenda 6(gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.

Neni 17 - Fitimet

- 17.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, duke zbritur 5% (pesë për qind) që caktohen për rezervën ligjore deri në 10% (dhjetë për qind) e kapitalit themeltar, dhe duke zbritur gjithashtu të gjitha shumat që Asambleja vendos ti verë mënjane, u shpërndahen ortakëve në proporcion me kuotat e kapitalit themeltar të zotëruara.
- 17.2 Asambleja mund të vendosë edhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.


KAPITULLI V SHPËRNDARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË

Neni 18 - Prishja

- 18.1 Shoqëria prishet me përfundimin e afatit të parashikuar nga Statuti, ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji, me vendim të Asamblesë së Ortakëve, me shumicën e kërkuar për ndryshimet në statut.
- 18.2 Shoqëria nuk prishet në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, pazotësisë juridike, vdekjes ose falimentimit të ortakëve.

Neni 19- Likuidimi

- 19.1 Në rast prishje, Shoqëria duhet të likuidohet.
- 19.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.

A handwritten signature in black ink, appearing to be a stylized name, possibly "Gjergj", written over a horizontal line.

19.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.

19.4 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakëve, në proporcion me kuotat e kapitalit të zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.

Neni 20-Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

20.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti dhe akti të themelimit, si dhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

20.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 21- Gjuha

21.1 Ky statut është i përbërë nga 2(dy) kopje në gjuhën shqipe.

21.2 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti dhe aktit të themelimit, versioni në gjuhën shqipe do të jetë e vetmja ligjërish e pranueshme.

ORTAKU I VETËM

Znj. Rozana Plaku

"FVF" SHPK
FUTURE VALUE FORMULA

